



SRPSKA LISTA -GISL

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2016 - 31 Dhjetor 2016

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se SRPSKA LISTA

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik SRPSKA LISTA (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “GISL”), te përbëra nga Pasqyra e Pozites Financiare me 31 Dhjetor 2016, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faq. 7-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit SRPSKA LISTA. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Ashtu siç prezantohet në pasqyrën e Pozitës financiare të bashkëngjitur për vitin 2016, detyrimet i tejkalojnë astetet dhe fondet e Subjektit politik për 32,179.79 euro për fitimin i cila është dashtë të bartet nga viti 2015 në vitin 2016 . Si pasoj ka një mbivlerësim të rezultatit të vitit pasi fondet e akumuluar, apo suficiti i vitit të kaluar, është prezantuar edhe si e hyre e vitit aktual dhe njëkohësisht dhe një nënvlerësim të fondeve të bartura .
- Ashtu siç prezantohet në Shënim 4 te pasqyrave financiare të bashkëngjitur, Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime në vlerë 215,886.72 për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne nuk kemi mundur të verifikojmë saktësinë e shpenzimeve të raportuara për vlerën 170,731.38 Euro për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2016.
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që SP politik nuk prezantuar sakte shënime krahasuese për vitin 2015 pasi ka mospërputhje të shënimeve të deklaruara me dhe për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 dhe shënimeve krahasuese për të njëjtin vit të prezantuara me dhe për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016.
- Në mungesë të konfirmimeve nga bankat ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse SP ka vetëm një llogari bankare ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 11, paragrafi 3.

- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që SP politik nuk ka prezantuar te gjitha pagesat mbi 5000 euro ne Pasqyrën e cila tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave që i janë bërë atij personi gjatë kësaj periudhe tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, duke shënuar edhe qëllimin e pagesës.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 EUR brenda një dite ne kundërshtim me kërkesat ligjore te Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit te terrorizmit, neni 25 pika 2 e Ligjit Nr. 03/L-169 Detyrimet shtesë të partive politike. ,
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpалosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin

bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Pasuritë afatgjata	Shënimi		
Toka, objektet dhe pajisjet		0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	2	99,793.08	32,179.00
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		99,793.08	32,179.00
Gjithsej pasuritë		99,793.08	32,179.00
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar			
Suficiti / (deficiti) i vitit		99,793.07	32,179.69
Gjithsej Ekuiteti		99,793.07	32,179.69
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		0.00	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera		0.00	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet		0.00	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		99,793.07	32,179.69

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2016	2015
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		283,500.00	283,500.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla		0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime			
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		32,179.79	53,754.00
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		315,679.79	337,254.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompenzimet	3	45,455.34	11,701.40
Shpenzimet e transportit	3	42,100.44	65,049.11
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	3	58,636.18	116,485.38
Shpenzimet e fushatës	3	0.00	
Blerja e mallrave	3	1,455.01	40,016.03
Shpenzimet e përgjithshme	3	67,180.37	54,930.00
Shpenzimet e ndryshme	3	1,059.38	16,892.39
Gjithsej shpenzimet për vitin		215,886.72	305,074.31
Suficiti / (deficit) për vitin		99,793.07	32,179.69

1. Informata te përgjithshme

Subjekti politik : SRPSKA LISTA (Srpska Lista – GISL)

Udhëheqja: Aleksander Jabllanovic (Kryetar i partisë)

Themelues: Aleksander Jabllanovic

Pasqyrat financiare te Listes Serbe janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën TEB.

Shënimi 2. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Paraja në bankë	99,793.08	32,179.00
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	99,793.08	32,179.00

Shënimi 3: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto	34,300.00	34,300.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	1,814.33	1,814.33	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	1,814.33	1,814.33	0.00
Tatimet në të ardhura personale	2,403.98	2,403.98	0.00
Beneficionet tjera	5,122.70	5,122.70	0.00
Gjithsej	45,455.34	45,455.34	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	17,590.00	17,590.00	0.00
Karburantet	5,568.29	5,568.29	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	4,392.05	4,392.05	0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave	1,514.50	1,514.50	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	13,035.60	13,035.60	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	42,100.44	42,100.44	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	0.00	0.00	0.00
Ushqimi	14,593.00	14,593.00	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	0.00	0.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00	0.00	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	0.00	0.00	0.00

SRPSKA LISTA

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	44,043.18	44,043.18	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	58,636.18	58,636.18	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	1,413.80	1,413.80	0.00
Pajisjet të vogla	41.21	41.21	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	1,455.01	1,455.01	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	63,140.00	63,140.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	4,040.37	4,040.37	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	//////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	0.00	//////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	67,180.37	67,180.37	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	1,059.38	1,059.38	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,059.38	1,059.38	0.00
Gjithsej shpenzimet	215,886.72	215,886.72	0.00

Shënimi 3: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Shpenzimet e reprezentacionit	Viprint	Mitrovica	70938278	05.02.2016	4,112.30
Shpenzimet e reprezentacionit	Viprint	Mitrovica	70938278	15.04.2016	1,950.00
Shpenzimet e reprezentacionit	Fati NTP	Mitrovica	71134830	07.04.2016.	14,040.00
Huazim i automjeteve	Xhemi G NTSH	Mitrovica	71017559	07.04.2016	17,590.00
Ushqim dhe pije	Fast Food Menar DPH	Mitrovica	71083659	07.04.2016.	8,370.00
Shpenzimet e reprezentacionit	Viprint	Mitrovica	70938278	02.08.2016	810.00
Shpenzimet e reprezentacionit	Viprint	Mitrovica	70938278	01.11.2016	82.60
Shpenzimet e reprezentacionit	Viprint	Mitrovica	70938278	19.12.2016	2,300.00
Qiraja per zyre	Stanoje Dimitrijevic	Gracanica		27.01.2016	7,710.00
Qiraja per zyre	Nikola Dimitrijevic	Gracanica		27.01.2016	7,875.00
Qiraja per zyre	Stanoje Dimitrijevic	Gracanica		22.04.2016	7,710.00

SRPSKA LISTA

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

Qiraja per zyre	Nikola Dimitrijevic	Gracanica		22.04.2016	7,875.00
Qiraja per zyre	Stanoje Dimitrijevic	Gracanica		13.07.2016	7,710.00
Qiraja per zyre	Nikola Dimitrijevic	Gracanica		13.07.2016	7,545.00
Qiraja per zyre	Stanoje Dimitrijevic	Gracanica		14.10.2016	7,380.00
Qiraja per zyre	Nikola Dimitrijevic	Gracanica		14.10.2016	7,215.00
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					110,274.90